

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit (Programi: Master i mësimdhënies në matematikë
Titulli i lëndës:	Hulumtimi në veprim
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	II (Sem IV)
Numri i orëve në javë:	(2+1 orë)
Vlera në kredi – ECTS:	5 ECTS
Koha / lokacioni:	E hënë 14.00 - 15.30
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Dr. Eda Vula
Detajet kontaktuese:	eda.vula@uni-pr.edu ;
Përshkrimi i lëndës	
	<p>Ky kurs është planifikuar me qëllim të njohjes me hulumtimin në veprim si një formë e kërkimit sistematik dhe si proces i reflektimit për praktikën mësimore në lëndën e matematikës. Në këtë kurs do të shqyrtohen hapat e implementimit të një projekti hulumtues në klasë, shkollë dhe institucionet tjera arsimore.</p> <p>Studentët do të analizojnë një shumëllojshmëri të perspektivave të qëllimeve të hulumtimit në veprim, bazën teorike, etikën, proceset dhe çështjet e përfshira në planet e veprimit. Ata do të shqyrtojnë karakteristikat themelore të hulumtimit në veprim dhe llojet e tyre, identifikimin e problemeve, hapat e realizimit të hulumtimit në klasë dhe raportimin e tyre.</p>
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i këtij kursi është përgatitja e studentëve për zbatimin e praktikave efikase të mësimdhënies së matematikës nëpërmjet hulumtimeve në klasë.
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> shqyrtojnë lidhjen midis teorisë, hulumtimit dhe praktikave të mësimdhënies së matematikës; analizojnë në mënyrë kritike artikujt dhe literaturën shkencore në lidhje me problemet e identifikuara të fushës së edukimit matematikor; shqyrtojnë ndikimin e hulumtimit në veprim në përmirësimin e praktikave mësimore;

	<ul style="list-style-type: none"> • demonstrojnë aftësi për planifikimin dhe zhvillimin e një cikli të hulumtimit në klasë/shkollë; • zhvillojnë një projekt hulumtimi dhe shkruajnë raportin e atij hulumtimi; • reflektojnë rreth praktikës profesionale në kontekst të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies dhe të rezultateve të nxënies në fushën e matematikës
--	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	8	8
Ushtrime në teren	2	4	8
Kollokfiume,seminare			
Detyra të shtëpisë	2	12	24
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	12	36
Përgaditja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	1	2
Projektet,prezentimet ,etj	2	2	4
Totali			127

127 : 25 ≈ 5 ECTS

Metodologjia e mësimdhënies:	Në këtë kurs do të zbatohen metodat ndërvepruese të mësimdhënies, duke i angazhuar studentët në diskutime për çështje të rëndësishme, duke u bërë të mundur që të reflektojnë mbi përvojën e tyre dhe duke i lejuar ata të shprehin idetë e tyre, besimet, dhe përvojat rreth temave të caktuara në kontekst të përmirësimit të praktikës së tyre profesionale.
-------------------------------------	---

	dizajneve të HV. Kap.5	parë të dizajnit të hulumtimit
Java e shtatë:	Mbledhja e të dhënave sasiore. Hartimi i planit për mbledhjen e të dhënave; teknikat dhe metodat për mbledhjen e të dhënave. Kap.6	Shqyrtim i instrumenteve për mbledhjen e të dhënave
Java e tetë:	Mbledhja e të dhënave cilësore. Hartimi i planit për mbledhjen e të dhënave; teknikat dhe metodat për mbledhjen e të dhënave Kap.6	Mbledhja e të dhënave në klasat hulumtuese
Java e nëntë:	Analiza dhe interpretimi i të dhënave sasiore.Kap.7	Mbledhja e të dhënave - vazhdim
Java e dhjetë:	Analiza dhe interpretimi i të dhënave cilësore.Kap.7	Mbledhja e të dhënave dhe fillimi i analizës
Java e njëmbëdhjetë:	Diskutimi dhe plani i veprimeve Kap.8	Analiza e të dhënave vazhdon dhe diskutohen me 'miqt kritik' planet e veprimeve
Java e dymbëdhjetë:	Shkrimi i raporteve të hulumtimeve. Kap.9	Finalizimi i shkrimit të raporteve
Java e trembëdhjetë:	Prezantimi i projekteve hulumtuese	Reflektime
Java e katërbëdhjetë:	Prezantimi i projekteve hulumtuese	Reflektime
Java e pesëmbëdhjetë:	Provim përfundimtar	

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Çdo student duhet të:

- Viojë me rregull ligjëratat;
- Lexojë literaturën e kërkuar dhe artikujt e sugjeruar, të marrë pjesë në diskutime në klasë, të përgatitet për të gjitha aktivitetet tjera;
- Përgatisë dhe të dorëzojë të gjitha detyrat në kohën e duhur. Çdo vonese do të ndëshkohet me pikë të humbura;
- Përdorë stilin APA në të gjitha detyrat e shkruara
- Prezantojë raportin e projektit hulumtues të tij/saj në klasë;
- Kopjimet/plagjiatura gjatë provimeve dhe kryerjes së detyrave ndëshkohen sipas procedurave të miratuara në KF
- Gjatë orëve mësimore nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë dhe ardhja me vonesë apo largimi nga ora pa arsye.